

NAIM BERISHA

**KONTRIBUTI I ALBANOLOGES MARIJA HRISTOVA
GEORGIEVA PËR TË FOLMEN E FSHATIT MANDRICË**

811.18'282(497.2)

Studimet gjuhësore për të folmet e diasporës arbëreshe për një kohë të gjatë kanë qenë fokus i studiuesve të ndryshëm, veçanërisht të folmet arbëreshe të Italisë dhe Greqisë. Krahas tyre, vëmendje i është kushtuar edhe të folmes shqipe të katundit Mandrica në Bullgari. Për këtë të folme kanë shkruar Dh. S. Shuteriqi, M. Domi, B. Sokolova, Gj. Shkurtaj etj. Objekt trajtimi në këtë kumtesë është një kontribut tjetër për këtë ishull gjuhësor të shqipes, pra “*Fjalori bisedimor bullgarisht-shqip me fjalorth*” i studiueses mandricase Marija Hristova Georgieva.

Sipas studiuesve të përmendur më lart, në Bullgari ka pasur disa ngulime shqiptare, ose më saktësisht disa fshatra, por sot, e folmja shqipe e Mandricës është i vetmi ngulim shqiptar në të cilin është ruajtur gjuha dhe traditat. Shqipja e Mandricës, sipas Sokolovës, ruan një numër të madh veçorish të moçme dhe ka një fytyrë mjaft arkaike (konservative), por edhe ndikimi nga mjedisi i huaj i ka dhënë asaj disa karakteristika, që nuk i përkasin gjuhës shqipe të trevave prej nga janë shpërngulur mandricasit¹. Këto janë zhvillime normale sepse e folmja shqipe e Mandricës ka qenë në takim a simbiozë me bullgarishten, mund të themi në njëfarë bashkëjetese të pandërprerë. Shqipja ka qenë dhe është gjuhë e zemrës për mandricasit por me përdorim kryesisht në familje. Veç kësaj, e folmja e Mandricës ka pësuar ndikime edhe nga gjuha turke, si gjuhë e popullit sundues dhe nga gjuha greke, si pasojë e kontakteve fqinjësore, martesave etj., por edhe nga shkolla e fshatit e cila deri më 1912 ishte në gjuhën greke. Sipas këtyre të dhënave të cilat më hollësisht i kanë trajtuar studiuesit e lartpërmendur, del se deri më 1912, pjesa mashkullore e popullsisë shqiptare të Mandricës ishte katërfish poliglote. Për këtë realitet gjuhësor nuk mund të flitet në ditët e sotme. Sipas Gj. Shkurtajt, “sot askush nuk flet më në këto gjuhë në Mandricë, me përjashtim të ndonjë plaku, që i flet me vështirësi. Kjo dëshmon se, së paku qysh më 1912-n e këtej, në vend të katërgjuhësisë, edhe popullsia mashkullore e Mandricës ka kaluar në dygjuhësi: bullgarisht-shqip². Kur i kemi parasysh rrethanat në të cilat u ruajt shqipja në Mandricë, nën ndikimin e fuqishëm të bullgarishtes dhe pastaj të turqishtes e greqishtes, studiuesit shprehen se ruajtja e shqipes është meritë sidomos e gjinisë femërore.

Siç e thamë në fillim, objekt trajtimi në këtë kumtesë është “*Fjalori bisedimor bullgarisht-shqip me fjalorth*” i studiueses mandricase Marija Hristova Georgieva. Në këtë trajtesë është marrë në shqyrtim një pjesë e materialit gjuhësor të një diaspore gjuhësore mjaft të hershme dhe me ndikime të fuqishme nga gjuhët në kontakt dhe përreth saj. Botimi i këtij fjalori në vitin 2015 është kontribut i rëndësishëm dhe material i mirë që të jep mundësi të bësh studime, por edhe krahasime me rezultatet e autorëve tjerë,

¹ Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 391.

² Po aty, f.398.

rezultatet e të cilëve ka kohë që janë publikuar, por është edhe një paraqitje reale e shqipes së folur në Mandricë në ditët e sotme.

Në pjesën hyrëse të këtij Fjalori është pasqyruar një historik i shkurtër për Mandricën, Ajo që bie në sy aty është viti i supozuar i themelimit të këtij ngulimi shqiptar. Aty thuhet se “fshati ka ruajtur bukurinë, pamjen autentike dhe gjuhën e vet që nga viti 1636”. Ndërsa, Dh, Shuteriqi¹ shprehet se sipas gojëdhënës thuhet se mandricasit janë nga Vithkuqi i Korçës dhe se fshati u themelua para se turqit ta marrin Stambollin (1453). Sipas tij, te kjo kohë aludon edhe kënga e mbledhur nga sh. Kolë Jakova në Manbdricë, pastaj, këto të dhëna i mbështet edhe në të gjeturat e Nolit, ku sipas tij këto fshatra u themeluan nga mercenarë shqiptarë të kohës së Bizantit. Po sipas Shuteriqit, në një gojëdhënë tjetër thuhet se fshati u themelua në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Këto të dhëna për vitin e mundshëm të themelimit të këtij lokaliteti i kanë i kanë trajtuar dhe prezantuar edhe studiuesit tjerë të përmendur në këtë punim.

Fjalori është i ndarë në dy pjesë, *Gramatikë e shkurtër* dhe *Fjalor bisedimor*. Materiali i vjelë është pasqyruar në 4 kolona, dy bullgarisht dhe dy shqip. Njëra kolonë në shqip e paraqet fjalën si përdoret në të folmen e këtij katundi, kolona e dytë kuptimin dhe variantin në shqipen standarde.

Në pjesën e parë, Gramatikë e shkurtër, autorja i ka listuar një numër të konsideruar fjalësh të ndara sipas disa pjesëve të ligjëratës, si: *mbiemra, numërorë, folje* dhe *ndajfolje*.

Aty janë paraqitur mbiemra si: *evash – i ngadaltë, sumurë – i, e sëmurë, sellë – i thellë, sartë – i e thartë, duhor – i, e duhur, shkurtor – i, e shkurtër, ulltë – i, e ulët, tëmlle – i, e ëmbël* etj. Shihet se ndikimi i bullgarishtes mbi shqipen e Mandricës ka lënë gjurmë, në mjaft raste përputhen të gjeturat e studiuesve tjerë për fonetikën, morfologjinë e sintaksën e kësaj të folmeje me materialet e paraqitura në fjalor. Pra, sipas këtyre të dhënave, në disa raste një –ë paratheksore ka kaluar në –u, kjo dëshmohet edhe nga shembujt që i përmendëm, si: *sumurë – i, e sëmurë*; por edhe në emra e ndajfolje, si: *kupucë, kushtu, kutu* etj. Dukuri tjetër fonetike që ka ndodhur nën ndikimin e bullgarishtes është kalimi ose zhdukja e **th**-së në **z/s**, si: *sellë – i thellë, sartë – i e thartë*. Sipas Gj. Shkurtajt, kjo dukuri fonetike del edhe te pjesët tjera të ligjëratës, *zjetë – dhjetë, trizjetë* etj. Dukuri tjetër fonetike karakteristike për këtë të folme, e cila na paraqitet edhe te mbiemrat është edhe kalimi i *o*-së paratheksore në –u dhe anasjelltas, shembujt nga fjalori: *duhor – i, e duhur, bukor-i, e bukur*; pastaj kalimi i ë-së në –o: *shkurtor – i, e shkurtër; djegor- i, e djegës* etj.

Sipas listë së mbiemrave që janë pasqyruar në fjalor, në të folmen e Mandricës dalin edhe disa mbiemra që janë të njëjtë ose shumë të afërt me trajtat e tyre të shqipes standarde, si: *lartë – i, e lartë, trashë – i, e trashë, mirë – i, e mirë, zënë – i, e zënë, haptë – i, e hapur, plak – i, e vjetër, plak – i, e moshuar, ngroftë – i, e ngroftë, gerë – i, e gjerë* etj. Karakteristikë tjetër e përdorimit të mbiemrave në të folmen e Mandricës është se, nën ndikimin e bullgarishtes, mbiemrat vihen përpara emrit që cilësojnë, p.sh.: *bardë bukë* (sipas bullgarishtes *bjal hljeb*) – për bukë e bardhë, *bukorë djalë* (*hubavo momce*) – djalë i bukur) etj².

Në grupin e dytë të fjalëve janë renditur numërorët. Edhe këtu bie në sy ndikimi i bullgarishtes, numrat nga 1-10 në të folmen e Mandricës janë: *nulla, ni, dju, tri, katrë, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, zjetë*. Përveç zeros që është ndërruar komplet në *nulla*, ndikimi i bullgarishtes vërehet edhe te numri dy dhe numrat tjerë më të mëdhenj që formohen me të. Këtu kemi kalim të zanores **y** të shqipes në **ju**, si: *dju* (2), *djumbëzjetë* (12), *djuzjetë* (40), *djukint* (200) etj. Bie në sy edhe mospërdorimi i bashkëtingëlloreve dhëmbore. Sipas Dh. Shuteriqit dhe M. Domit³, nën ndikimin e bullgarishtes ka ndodhur zhdukja e plotë e

¹ Dhimitër Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica*, SF 1, Tiranë, 1965, f. 105,

² Gj. Shkurtajt, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009, f. 317.

³ Dh. Shuteriqi, M. Domi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF 2, Tiranë, 1968, f. 106.

bashkëtingëlloreve ndërdhëmbore, *th* ka dhënë kryesisht *s*, pasqyrohet edhe te mbiemrat që i paraqitëm më lart: *sellë – i, e thellë, sartë – thartë, djasë – djathë* etj., dhe *dh* ka kaluar në *d* e në *z*. Ky kalim del te numërorët që i përmendëm, *zjetë, djumbëzjetë, trembëzjetë* etj., por edhe *bardë – bardhë, verdë – vedhë* etj. Sipas fjalorit, ngjashëm dalin edhe numërorët rreshtorë: *njija- i parë, djuja- i dytë, trija, katra, pesa, gjashta, shtata, teta, nënta, zjeta* etj. Veç këtyre, bie në sy se disa numërorë janë ruajtur mirë, përdoren pothuajse njëjtë me shqipen e sotme, si: *tri, katër, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë* etj. Foljet janë pasqyruar pak më ndryshe, janë dhënë shembuj të zgjedhimit të foljeve *jam, kam* dhe *marr* në kohën e tashme, njëjës dhe shumës:

unë jam, neve jemi, unë kam, neve kemi, unë mar, neve marmë

tinë jesh, iva jeni, tinë kesh, iva keni, tinë marësh, iva merni

(ai)aju është, ata janë,aju ka, ata kanë,aju mer, ata marnë

(ajo)aju është

Veç tjerave, bie në sy edhe kalimi i *i-së* së theksuar në *ju* në vetën e tretë njëjës, *aju është* – për *ai është*. Me sa kemi vërejtur, këtë kalim nuk e kanë përmendur studiuesit e konsultuar për këtë punim. Foljet e njëjta janë pasqyruar edhe në të kryerën e thjeshtë: *klleshë – qeshë, unë kllesha (qeshë), ti klleshe,aju kle; neve kllemë, iva kletë, ata kllenë*, etj.

Për kohën e ardhme janë pasqyruar këto folje: *unë ot jam – unë do të jem, tinë ot jesh,aju ot është; neve ot jemi, iva ot jeni, ata ot jenë*. Format e së ardhmes me *do të* që i ka shqipja kanë evoluar në *ot*. Sipas këtij fjalori, mohorja e foljeve del kryesisht e formuar me pjesëzën *nuk*, pra si në shqipen e sotme. Megjithatë, M. Domi dhe Dh. Shuteriqi shprehen se: “Pjesëza mohuese *nuk* del në format *nuku*, e *nukë*, dhe se ka përdorim të shpeshtë trajta *sun* për *s’ mund*¹”.

Pas kësaj pjese janë listuar një numër i konsiderueshëm foljesh të cilat autorja i ka ndarë me titullin: *Folje me përdorim të shpeshtë*. Në këtë pjesë të Fjalorit, bien në sy folje të ndryshme të cilat i vërtetojnë dukuritë fonetike e morfologjike të kësaj së folmeje, për të cilat tashmë kemi informacione nga studimet e mëhershme, si: *shkron – shkruaj, ot shkron –do të shkruaj, som – them, dva – dua, mbjell – mbyll, mblez – mbledh, lozem – lodhem* etj. Pastaj folje të konsideruara arkaike: *këndon – lexoj, këndon – këndoj, ligem – dëgjoj, zallahin – flas* etj.

Edhe te ndajfoljet e pasqyruara, përmes alternimeve të ndryshme të tingujve vërehet ndikimi i bullgarisht, si: *djesna – dje, lotur – rrotull, agikun – asgjekund* etj., por edhe ndonjë huazim oriental si *saballe – herët* etj.

Pjesa e dytë e titulluar *Fjalor bisedimor* është një material shumë i rëndësishëm. Aty janë listuar fjalë e shprehje të klasifikuara sipas situatave ligjërimore të përdorimit, si: *Pranim-miratim, refuzim, falënderime, përshëndetje, urime, festa, njohja, vizita, mbishkrime, mosha, familja, profesione, koha* etj. Që në fillim të kësaj pjese vërehet ndikimi i bullgarishtes, jo vetëm në procese të ndryshme fonetike e morfologjike por edhe në leksik, me huazime të shumta. Te kategoria e klasifikuar si *Pranim, miratim*, janë pasqyruar fjalë e shprehje si: *da –po, drektë keni – Ju keni të drejtë* etj., por edhe fjalë tjera të cilat përdoren njëjtë edhe në shqipen standarde, si: *ashtu, ashtu më duket, mirë* etj. Te grupi i njëjësive *mospranim, refuzim* kemi fjalë e shprehje si: *nuku – jo, nuk jeni ndrektë –nuk keni të drejtë, praptën – përkundrazi, në të kundërt* etj. te kjo pjesë bie në sy se mohorja nuk del e formuar vetëm me pjesëzën *nuk*, pra si në shqipen e sotme siç e ka prezantuar autorja te pjesa e dedikuar për foljet. Mbase është një lëshim i vogël sepse ky shembull dhe të tjerë më tutje e vërtetojnë të gjeturat e M. Domit dhe Dh. Shuteriqit se “Pjesëza mohuese *nuk* del në format *nuku*, e *nukë*, dhe se ka përdorim të shpeshtë trajta *sun*

¹ M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen e Mandricës*, SF 2, Tiranë, 1965, f. 115.

për *s'mund'*. Paraqitja se fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme në këtë fjalor është mjaft e gjerë. Grupimi i leksikut është bërë sipas ndarjeve të përmendura më sipër por edhe të tjera.

Në fund, mund të themi se botimi i këtij fjalori është padyshim një punë shumë e rëndësishme, e cila e paraqet përmbledhtas pasurinë gjuhësore të të folmes së Mandricës që gjallon në ditët e sotme. Përveç punës së çmueshme që ka bërë autorja, rëndësia e këtij Fjalori është e madhe sepse e arkivon pasurinë gjuhësore të këtij ishulli gjuhësor të shqipes në kohën kur trysnia e bullgarishtes por edhe gjuhëve tjera në kontakt e rrezikojnë shumë këtë të folme.